

Një projekt i Agjencisë Zvicerane për  
Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim  
dhe Bashkëpunim SDC

Zbatuar nga:



Save the Children



# PLANI I PËRMIRËSIMIT TË VEPRIMTARIVE VJETORE QË KONTRIBUOJNË NË SHËNDETIN E NXËNËSVE

Korçë

## Përmbajtje

AKRONIME.....	4
1. Hyrje.....	5
1.1 Qëllimi .....	6
1.2 Vizioni .....	6
1.3 Misioni.....	6
1.4 Objektivat.....	6
2. Veprimet për Planin e Përmirësimit .....	7
2.1 Kapaciteti i shkollës në drejtim të vlerësimit të situatës dhe nevojave shëndetësore dhe mirëqenies.....	8
2.1.1 Qëllimi kryesor .....	8
2.1.2 Nën-Objektiva .....	8
2.1.3 Indikatorët e Performancës .....	9
2.1.4 Lista e veprimeve.....	9
2.1.5 Lista e projekteve.....	10
2.2 Shëndeti dhe mirëqenia si pjesë e planeve të shkollës .....	18
2.2.1 Qëllimi kryesor .....	18
2.2.2 Nën-Objektiva .....	18
2.2.3 Indikatorët e Performancës .....	18
2.2.4 Lista e veprimeve.....	19
2.2.5 Lista e projekteve.....	19
2.3 Mjedisi fizik në shkollë .....	23
2.3.1 Qëllimi kryesor .....	23
2.3.2 Nën-Objektiva .....	23
2.3.3 Indikatorët e Performancës .....	23
2.3.4 Lista e veprimeve.....	24
2.3.5 Lista e projekteve.....	24
2.4 Mjedisi social në shkollë.....	28
2.4.1 Qëllimi kryesor .....	28
2.4.2 Nën-Objektiva .....	28
2.4.3 Indikatorët e Performancës .....	28

2.4.4	Lista e veprimeve.....	29
2.4.5	Lista e projekteve.....	29
2.5	Nxitja e aftësive për përmirësimin e shëndetit.....	31
2.5.1	Qëllimi kryesor.....	31
2.5.2	Nën-Objektiva.....	31
2.5.3	Indikatorët e Performancës.....	31
2.5.4	Lista e veprimeve.....	32
2.5.5	Lista e projekteve.....	32
2.6	Lidhja e shkollës me komunitetin e prindërve dhe më gjerë.....	35
2.6.1	Qëllimi kryesor.....	35
2.6.2	Nën-Objektiva.....	35
2.6.3	Indikatorët e Performancës.....	35
2.6.4	Lista e veprimeve.....	36
2.6.5	Lista e projekteve.....	36
2.7	Stafi i shkollës.....	41
2.7.1	Qëllimi kryesor.....	41
2.7.2	Nën-Objektiva.....	41
2.7.3	Indikatorët e Performancës.....	42
2.7.4	Lista e veprimeve.....	42
2.7.5	Lista e projekteve.....	43
2.8	Menaxhimi i procesit të promocionit të shëndetit dhe mirëqenies nga shkolla.....	45
2.8.1	Qëllimi kryesor.....	45
2.8.2	Nën-Objektiva.....	45
2.8.3	Indikatorët e Performancës.....	45
2.8.4	Lista e veprimeve.....	46
2.8.5	Lista e projekteve.....	46

## **AKRONIME**

ZVAP- Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar

NJVKSH- Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor

CU- Cikël i Ulët

AF- Arsim Fillor

AMU- Arsim i Mesëm i Ulët

DN- Dispozitë Normative

AK- Aftësi e Kufizuar

PEI- Plan Edukativ Individual

OJF- Organizata Jo Fitimprurëse

IA- Institucion Arsimor

DROSHKSH- Drejtoria Rajonale e Operatorit të Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor

## 1. Hyrje

Projekti “Shkollat për Shëndetin” ka hartuar një Plan Përmirësimi të Shërbimit i kontekstualizuar në bazë të problematikave që shkollat kanë, duke identifikuar mangësitë dhe nevojat për përmirësimin e shkollave në aspektin shëndetësor. Në Korçë është bërë vlerësimi i detajuar i shkollave në lidhje me aspekte të sjelljeve shëndetësore, duke u bazuar në tre studime të realizuara nga projekti “Shkollat për Shëndetin”: “Indeksi Shëndetësor i Shkollës (SHI)”, “Karakteristikat e Sjelljeve Shëndetësore tek Nxënësit e Shkollave (HBCS)”, dhe “Kompetencat Shëndetësore tek Nxënësit” (Health Literacy, HL), si dhe statistikat zyrtare vjetore që raportojnë vetë shkollat.

Qëllimi i këtij plani është hartimi i një platforme strategjike dhe gjithëpërfshirëse që do të hedhë bazat për një zhvillim të qëndrueshëm dhe cilësor për të gjitha strukturat e arsimit bazë në aspektin shëndetësor. Planit i përmirësimit synon të përmbushë nevojën për të harmonizuar të gjitha aktivitetet zbatuese që lidhen me shëndetin në një vizion të përbashkët dhe koherent të fokusuar në disa objektiva strategjike.

Qëllimi i planit vjetor për përmirësimin e promovimit shëndetësor në shkollë është të ndikojë në shëndetin dhe mirëqenien e nxënësve nëpërmjet ofrimit të një mjedisi të shëndetshëm dhe mbështetjes në nxitjen e sjelljeve dhe aktiviteteve të shëndetshme.

Kjo mund të arrihet përmes ngritjes së ndërgjegjësimit dhe edukimit të nxënësve për rëndësinë e një diete të shëndetshme, aktivitetit fizik dhe higjenes personale, si dhe përmes organizimit të aktiviteteve dhe evenimenteve shëndetësore në shkollë.

Planifikimi i strategjive të shëndetshme dhe sigurimi i një mjedisi mbështetës dhe inkurajues mund të ndikojnë në rritjen e kulturës së shëndetit dhe mirëqenies së nxënësve në shkollë, si dhe për integrimin e nxënësve me nevoja të veçanta.

Në planin e përmirësimit sugjerojmë shtimin dhe përfshirjen e aktiviteteve të reja në planin e veprimtarive plotësuese dhe jashtëshkollore, që lidhen me sjelljet e shëndetshme.

Propozimi mbi aktivitetet e reja, është shoqëruar me skenarë mbi mënyrën se si këto aktivitetet do të zbatohen në praktikë, duke marrë parasysh në çdo rast strukturat, kapacitetet dhe burimet në dispozicion në nivel vendor.

Hartimi i kalendarit të aktiviteteve, u zhvillua duke mbajtur parasysh parimet e mëposhtme:

- qëllimi final (promovimi i shëndetit dhe i mirëqenies së fëmijëve)
- transparenca, qartësia, prakticiteti, dhe fleksibiliteti i ndërhyrjeve
- mandati, përgjegjësitë, gjithëpërfshirja dhe konsultimi i ndërhyrjeve
- shpërndarja dhe konsultimi i gjerë i planit në grupet e interesit
- bashkëpunimi dhe koordinimi
- përshtatshmëria dhe koherenca
- kapacitetet dhe burimet disponibël në nivel vendor

## 1.1 Qëllimi

Qëllimi i hartimit të Planit të Përmirësimit me fokus shëndetin është të ndihmojë shkollat në përmirësimin e procesit të raportimit të shkollave si dhe në integrimin e aktiviteteve në planin vjetor me fokus promovimin e sjelljeve të shëndetshme tek nxënësit e shkollave.

Hartimi i këtij plani ka ardhur si rrjedhojë e identifikimit të nevojave për:

- Ofrimin e një **qasjeje sistemike, të strukturuar, strategjike dhe të qëndrueshme** për promovimin e sjelljeve të shëndetshme dhe krijimin e një kulture shëndetësore në shkolla.
- **Pajtueshmëria me Standardet Kombëtare:** në fushën e Arsimit dhe Shëndetësisë, por edhe në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare dhe rekomandimet e OBSH lidhur me programet e promovimit shëndetësor në shkolla.
- **Qëllimi dhe objektivat specifike** që shkolla dëshiron/duhet të arrijë në lidhje me promovimin e sjelljeve të shëndetshme. Përpjekjet janë të synuara drejt një rezultati specifik.
- **Sigurimi i transparencës, përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies:** shkollat janë përgjegjëse për zbatimin e objektivave të identifikuara dhe arritjen e rezultateve të dëshiruara. Ndërhyrja është e qëndrueshme dhe progresi matet.
- **Angazhim proaktiv i të gjitha palëve të interesuara:** nxënësit, prindërit, mësuesit, shërbimit psikosocial dhe ai shëndetësor i shkollës dhe anëtarët e komunitetit angazhohen në promovimin e sjelljeve të shëndetshme.

*Të gjithë punojnë së bashku drejt një qëllimi të përbashkët: shëndeti dhe mirëqenia e nxënësve!*

## 1.2 Vizioni

Promovimi i shëndetit dhe mirëqenies në Arsimin Bazë, nëpërmjet forcimit dhe përmirësimit të shërbimeve të promovimit shëndetësor në shkolla, shtimit të aktiviteteve dhe veprimtarive mbi promovimin e sjelljeve të shëndetshme, si dhe bashkëveprimin dhe fuqizimin e lidhjeve të shkollës me komunitetin në tërësi për t'iu përgjigjur nevojave të fëmijëve në mënyrë efektive dhe në kohën e duhur.

## 1.3 Misioni

Shtimi dhe përmirësimi i gamës dhe cilësisë së programeve dhe aktiviteteve të promovimit shëndetësor me fokus promovimin e shëndetit dhe mirëqenies për çdo fëmijë të arsimit bazë.

## 1.4 Objektivat

Impakti në nivel shkollash:

- Rritje e aksesit dhe përdorimit të shërbimeve të promovimit shëndetësor: Nxënësit do të kenë akses në një sërë shërbimesh të promovimit shëndetësor, duke përfshirë ekzaminimet dentare dhe të syve, imunizimet, dhe shërbimet e shëndetit mendor.

- Rritja e cilësisë së kujdesit shëndetësor:  
Plani përfshin qëllime që lidhen me përmirësimin e cilësisë së kujdesit të ofruar nga shërbimet e promovimit shëndetësor në shkollë.
- Adresimi i pabarazive shëndetësore:  
Të gjithë nxënësit do kenë akses në burimet dhe arsimin që u nevojitet për t'u angazhuar në sjellje të shëndetshme.
- Forcimi i edukimit shëndetësor:  
Zhvillimi i programeve të edukimit shëndetësor për t'i induktuar nxënësve sjellje të shëndetshme dhe zgjedhje adekuate të stilit të jetesës, përmes krijimit të një kulture shëndetësore në shkollë.

## 2. Veprimet për Planin e Përmirësimit

Plani i përmirësimit do të hartohet duke u bazuar në tetë komponentët kryesorë të Indeksit Shëndetësor të Shkollave, të evidentuar për vlerësimin e shkollave në aspektin e shëndetit.

- 1.1 Kapaciteti i shkollës në drejtim të vlerësimit të situatës dhe nevojave shëndetësore dhe mirëqenies.
- 1.2 Shëndeti dhe mirëqenia si pjesë e planeve të shkollës
- 1.3 Mjedisi fizik në shkollë
- 1.4 Mjedisi social në shkollë
- 1.5 Nxitja e aftësive për përmirësimin e shëndetit
- 1.6 Lidhja e shkollës me komunitetin e prindërve dhe më gjerë
- 1.7 Stafi i shkollës
- 1.8 Menaxhimi i procesit të promovimit të shëndetit dhe mirëqenies nga shkolla

## 2.1 Kapaciteti i shkollës në drejtim të vlerësimit të situatës dhe nevojave shëndetësore dhe mirëqenies.

- Shëndeti fizik dhe mirëqenia e fëmijëve
- Shëndeti fizik dhe mirëqenia e stafit
- Shkolla vlerëson sjelljet shëndetësore të nxënësve
- Shkolla identifikon nevojat shëndetësore dhe dëshirat e nxënësve dhe stafit mësimor
- Shkolla ka një person përgjegjës për çështjet e shëndetit

### 2.1.1 Qëllimi kryesor

**Qëllimi kryesor:** Rritja e kapacitetit të shkollës në drejtim të vlerësimit të situatës dhe nevojave shëndetësore dhe mirëqenies.

### 2.1.2 Nën-Objektiva

- ✚ **Nën-Objektivi 1:** Disponimi i dokumentacionit dhe raporteve mbi mirëqenien fizike, psiko-emocionale dhe sociale të nxënësve të shkollave 9-vjeçare.
- ✚ **Nën-Objektivi 2:** Disponimi i dokumentacionit dhe raporteve mbi mirëqenien fizike dhe psiko-emocionale dhe sociale të stafit mësimor të shkollave 9-vjeçare.
- ✚ **Nën-Objektivi 3:** Disponimi i konkluzioneve të anketimeve/ sondazheve/pyetësorëve të cilat vlerësojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë gjendjen shëndetësore të nxënësve.
- ✚ **Nën-Objektivi 4:** Caktimi i koordinаторit të shëndetit në shkolla.

### 2.1.3 Indikatorët e Performancës

<b>Indikatorët e Performancës</b>		
<b>Matja e Indikatorëve të Performancës</b>	<b>Fakt 2022</b>	<b>Plan 2023</b>
Numri i raporteve që disponon shkolla mbi mirëqenien fizike të nxënësve.		
Numri i raporteve që disponon shkolla mbi mirëqenien psiko-emocionale të nxënësve.		
Numri i raporteve që disponon shkolla mbi mirëqenien psiko-emocionale të stafit të shkollës.		
Numri i raporteve që disponon shkolla mbi konkluzionet e anketimeve mbi gjendjen shëndetësore të nxënësve.		
Numri i psikologëve, punonjësve social në shkollë, për numër nxënësish		
Numri i mjekëve/infermiereve në shkollë, për numër nxënësish		
Numri i oficerëve të sigurisë në shkollë, për numër nxënësish		
Numri i mësuesve ndihmës për numër fëmijësh me aftësi të kufizuara në shkollë		
Disponimi i koordinatorit të shëndetit në shkollë		
Numri i aktiviteteve të promovimit shëndetësor të organizuara/koordinuara nga koordinatori shëndetësor		

### 2.1.4 Lista e veprimeve

<b>Nr.</b>	<b>Nën-objektivi</b>	<b>Veprimi</b>	<b>Përgjegjës</b>
<b>1.</b>	Shkollat raportojnë tek ZVA, konkluzionet e anketimeve /sondazheve/ pyetësorëve të cilat vlerësojnë në mënyrë të	Pas çdo pyetësi/ anketimi duhet të raportohet në formë narrative /statistikore konkluzionet e nxjerra, duke ruajtur anonimitetin e nxënësve.	Drejtori i IA

	drejtpërdrejtë gjendjen shëndetësore të nxënësve.		
2.	Vendosja e një koordinatori shëndeti në shkollë	Në shkollë vendoset një koordinator shëndeti i cili është përgjegjës për koordinimin dhe harmonizimin e përgjithshëm të programeve të promovimit të shëndetit të zbatuara në nivel shkolle.	Drejtori i IA

### 2.1.5 Lista e projekteve

<b>Nr. 1</b>	<b>Projekti:</b> Raportimi periodik nga shkollat tek ZVAP, mbi mirëqenien psiko-emocionale dhe sociale të nxënësve.
<b>a) Përshkrim i shkurtër i projektit:</b>	
<p>Punonjësit social, psikologët duhet të raportojnë në mënyrë periodike, 3 herë në vit çdo fund periudhë, mbi çdo veprimtari, pyetësorë/sondazhe që zhvillohet me nxënësit, si dhe raportimi i emergjencave të nxënësve në shkolla sipas udhëzuesit për praktikën e punës së shërbimit psiko-social në shkollë.</p>	
<b>i. Situata:</b>	
<p>Njësia e shërbimit psiko-social ofron aktivitete për përmirësimin e mirëqenies psiko-sociale të nxënësve si këshillim individual, në grup, vlerësim psikologjik, referim pranë shërbimeve, aktivitete psikosociale me nxënësit, etj.</p> <p>Por jo të gjitha këto aktivitete raportohen sipas formatit standard të udhëzuesit.</p>	
Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për përmirësim	
<p>Stafi i punonjësve social, psikologët kanë mangësi në raportimin periodik të veprimtarive sipas udhëzuesit duke mos patur një panoramë të shtatës aktuale, të mirëqenies psiko-emocionale të tyre:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Matrica e raportimit për veprimtaritë e realizuara</li> <li>• Raportimi për veprimtaritë parandaluese</li> <li>• Raporti për aktivitetet vlerësuese</li> </ul> <p>Ky mos raportim na krijon një hendek në planet për të përmirësuar situatën e shëndetit mendor të nxënësve.</p>	
<b>ii Synimi i projektit</b>	
<p>Në bazë të veprimtarive që shërbimi psiko-social zhvillon me nxënësit të bëhet raportimi periodik, nga ku synohet rritja e numri të raportimeve.</p>	

### iii Aktivitetet kryesore të projektit

Çdo aktivitet i zhvilluar të raportohet sipas formatit të paraqitur në udhëzuesin për praktikën e punës së shërbimit psiko-social në shkollë.

#### zultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)

Drejtuesi i IA të raporton tek ZVAP në lidhje me mirëqenien psiko-emocionale, si dhe numrin e veprimtarive që zhvillohen në kuadër të përmirësimit dhe të promovimit të shëndetit mendor të nxënësve 6-16 vjeç.

Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira) Punonjësit social, psikologët, Drejtori i IA	Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj)
---	---

**Nr. 2**

**Projekti:** Raportimi periodik nga shkollat tek ZVA, mbi mirëqenien psiko-emocionale dhe sociale të stafit mësimor.

#### a) Përshkrim i shkurtër i projektit:

#### ii. Situata:

Njësia e shërbimit psiko-social ofron aktivitete për përmirësimin e mirëqenies psiko-sociale të stafit mësimor si këshillim individual, në grup, vlerësim psikologjik, referim pranë shërbimeve etj.

Por jo të gjitha këto aktivitete raportohen sipas formatit standard të udhëzuesit.

Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për përmirësim

Stafi i punonjësve social, psikologët kanë mangësi në raportimin periodik të veprimtarive sipas udhëzuesit duke mos patur një panoramë të shtatës aktuale, të mirëqenies psiko-emocionale të tyre:

- Matrica e raportimit për veprimtaritë e realizuara
- Raportimi për veprimtaritë parandaluese
- Raporti për aktivitetet vlerësuese

Ky mos raportim na krijon një hendek në planet për të përmirësuar situatën e shëndetit mendor të stafit mësimor.

ii Synimi i projektit	
<b>iii Aktivitetet kryesore të projektit</b>	
Çdo aktivitet i zhvilluar të raportohet sipas formatit të paraqitur në udhëzuesin për praktikën e punës së shërbimit psiko-social në shkollë.	
Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)	
Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira) Punonjësit social, psikologët, Drejtori i IA	Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj)

<b>Nr. 3</b>	<b>Projekti:</b> Kryerja e pyetësorit të HBCS nga psikologu/punonjësi social
<b>a) Përshkrim i shkurtër i projektit:</b>	
Çdo vit duhet zhvilluar pyetësori i HBCS nga psikologu/punonjësi social.	
<b>iii. Situata:</b>	
Në shkolla psikologu/punonjësi social zhvillon disa pyetësor në vit me nxënësit, prindërit dhe mësuesit me temë: “Bullizmi” “Dhuna” etj. Por nuk zhvillohet asnjë pyetësor që të vlerësoj sjelljet e shëndetshme të nxënësve, njohuritë mbi konceptet shëndetësore si dhe ekspozimin ndaj sjelljeve të rrezikshme. Prandaj propozohet të zhvillohet pyetësori i HBCS çdo vit.	
Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për përmirësim	
Psikologu dhe punonjësi social mbështesin sigurimin e mirëqenies së nxënësve dhe përmirësimin e sjelljes së tyre. Ata zhvillojnë pyetësorë/anketa/intervista/fokus grupe me nxënësit, prindërit dhe mësuesit, me qëllim që të njihen me këndvështrimet e tyre në lidhje me mirëqenien dhe sjelljen e nxënësve në shkollë.	
<i>Arsyet pse duhet të zhvillohet HBCS çdo vit në shkollë:</i>	
Përmes informimit mbi sjelljet e shëndetshme të nxënësve, njohurive mbi konceptet shëndetësore dhe ekspozimit ndaj sjelljeve të rrezikshme, identifikohet situata aktuale dhe masat që duhet të merren për të përmiruar këtë gjendje. Promovimi i sjelljeve të shëndetshme dhe të sigurta mes nxënësve është një pjesë e rëndësishme dhe themelore e misionit të shkollave, për	

t'u siguruar të rinjve njohuritë dhe aftësitë që u nevojiten për të qendruar të shëndetshëm dhe produktiv në të ardhmen.

Përmirësimi i shëndetit të nxënësve mund të rrisë kapacitetin e tyre për të mësuar, për të ulur numrin e mungesave në shkollë si dhe të përmirësojnë aftësinë e tyre fizike dhe vigjilencën mendore.

### ii Synimi i projektit

Të njohim qartësisht dëshirat dhe nevojat shëndetësore të nxënësve nëpërmjet pyetësorëve, dhe nëpërmjet raportimit ku të dhënat e nxënësve janë konfidenciale.

Ky pyetësor është ndërtuar për:

- të ndihmuar të gjithë fëmijët në përmirësimin e sjelljeve shëndetësore
- të informuar prindërit rreth situatës shëndetësore të fëmijëve të tyre
- të analizuar situatën shëndetësore të nxënësve dhe për të marrë masa për të përmirësuar shëndetin e tyre si dhe për të nxitur sjellje të shëndetshme tek nxënësit nga klasa e 6-9.

### iii Aktivitetet kryesore të projektit

Zhvillimi i pyetësorit mbi vlerësimin e karakteristikave shëndetësore të fëmijëve (HBCS) çdo vit nga psikologu/punonjësi social. Kryerja e pyetësorit mund të bëhet sipas kapaciteteve të shkollave në format letër ose online.

### Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)

Prioritizimi i kërkesave dhe përmirësimimi i kushteve aty ku është e arsyeshme, bazuar në dëshirat dhe nevojat shëndetësore të nxënësve në shkollë.

Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda) Psikologu/punonjësi social Nxënësit	Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj) Projekti “Shkollat për Shëndetin”
--	---

### e) Shpenzimet e llogaritura (për cdo aktivitet të mësipërm pika iii)

Shpenzimet për cdo aktivitet	Totali (mijë lekë)

Shuma:	
<b>f) Periudha e zbatimit:</b>	<b>g) Ndjek zbatimin e projektit:</b>

<b>Nr. 4</b>	<b>Projekti:</b> Trajnim i mësuesve të edukimit fizik mbi kryerjen e matjeve antropometrike
<b>a) Përshkrim i shkurtër i projektit:</b> Zhvillimi i trajnimeve për mësuesit e lëndës së edukimit fizik mbi kryerjen sipas standardit të matjeve të gjatësisë dhe peshës, duke llogaritur dhe BMI-në.	
<b>i. Situata:</b> Në shkolla mësuesit e lëndës së edukimit fizik zhvillojnë trajnime të ndryshme për të rritur njohuritë dhe kapaacitetin e tyre, por nuk kanë kryer asnjë trajnim mbi zhvillimin e matjeve antropometrike sipas standardeve apo për llogaritjen e BMI-së.	
Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për përmirësim	
Kryerja e matjeve antropometrike duhet të bëhet në mënyrë precize pasi gabime të vogla në peshë apo gjatësi na japin rezultate të gabuara në përlllogaritjen e BMI-së, prandaj është i nevojshëm trajnimi i mësuesëve të edukimit fizik mbi matjen sipas standardeve të nxënësve, si dhe sigurimi i mjeteve të nevojshme si peshore dixhitale dhe metër.	
<b>ii Synimi i projektit</b> Të rrisi kapacitetin dhe njohurit e mësuesve për të zhvilluar matjet antropometrike në mënyrën e duhur duke minimizuar gabimet.	
<b>iii Aktivitetet kryesore të projektit</b> Zhvillimi i trajnimit: “Matjet antropometrike” me të gjithë mësuesit e lëndës së edukimit fizik, në ciklin fillor dhe arsimin e mesëm të ulët.	
<b>b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)</b> Të gjithë mësuesit e edukimit fizik janë të trajnuar dhe kryejnë matjet antropometrike duke përdorur metodat e standartizuara.	

<p>Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda)</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Mësuesit e edukimit fizik</li> <li>- Drejtori i IA</li> </ul>	<p>Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj)</p> <p>Zhvillimi i trajnimeve nga projekti Projekti “Shkollat për Shëndetin” ose donator të tjerë.</p>
--	--

**e) Shpenzimet e llogaritura** (për cdo aktivitet të mësipërm pika iii)

Blerja e paisjeve për të realizuar matjet: peshore dixhitale dhe metër

Shpenzimet për cdo aktivitet	Totali (mijë lekë)
Shuma:	

**f) Periudha e zbatimit:**

**g) Ndjek zbatimin e projektit:**

<b>Nr. 5</b>	<b>Projekti:</b> Raportimi i matjeve antropometrike
<p><b>a) Përshkrim i shkurtër i projektit:</b> Zhvillimi i trajnimeve për mësuesit e lëndës së edukimit fizik mbi kryerjen e duhur sipas standardit të matjeve të gjatësisë dhe peshës, duke llogaritur dhe BMI-në.</p>	
<p><b>ii. Situata:</b></p> <p>Mësuesit e lëndës së edukimit fizik dhe shëndet, sipas planit të punës zhvillojnë matje antropometrike, ku bëhet matja e peshës, gjatësi, perimetri i vitheve dhe i belit. Matjet antropometrike zhvillohen 2-3 orë në fillim dhe në fund të vitit dhe hidhen në regjistër, por nuk raportohen tek ZVAP-ja si dhe nuk përlllogaritet BMI-ja.</p>	
<p>Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për përmirësim</p>	
<p>Duhet të kryhet raportimi i matjeve antropometrike, tek ZVA- ja në fillim dhe në fund të vitit kur kryhen sipas planit mësimor, në një format të thjeshtë exceli duke llogaritur BMI. Të dhënat që do ti dërgohen ZVA-së do ruajnë anonimitetin e nxënësve dhe privatësinë e tyre.</p>	

ii Synimi i projektit

Raportimi i matjeve antropometrike dhe BMI-së së nxënësve tek ZVAP.

**iii Aktivitetet kryesore të projektit**

- Plotësimi i një tabele të thjeshtë nga mësuesi i edukimit fizik dhe raportimi i saj nga drejtori i IA tek ZVA-ja, si mëposhtë:

Matja e gjatësisë	Matja e peshës	Llogaritja e BMI

**c) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)**

Dokumentimi i matjeve antropometrike nga çdo shkollë tek ZVA-ja, të cilat më pas janë të vlefshme në hulumtimet shkencore, për të identifikuar faktorët e rrezikut për sëmundjet e lidhura me moshën.

Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda) - Mësuesit e edukimit fizik - Drejtori i IA	Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj)
--	--

**Nr. 6**

**Projekti:** Vendosja e një koordinatori shëndeti në shkollë

**a) Përshkrim i shkurtër i projektit:**

Vendosja e një “Koordinatorit Shëndetësor” konsiderohet thelbësore për të siguruar praninë (disponueshmërinë) e një stafi përgjegjës (të caktuar) në çdo shkollë, i cili është përgjegjës për koordinimin dhe harmonizimin e përgjithshëm të programeve të promovimit të shëndetit të zbatuara në nivel shkolle.

**iii. Situata:**

Në nivel ndërkombëtar, programet e promovimit të shëndetit në nivel shkolle koordinohen nga një gamë e gjerë e personelit të shkollës, bazuar në burimet, traditën dhe rregulloret në dispozicion në çdo vend. Prandaj, në nivel global, nuk ka asnjë “standard të artë” për pozicionin (profilin) e një “Koordinatorit Shëndetësor” të shkollës, rolin e të cilit mund ta luajë një infermiere e trajnuar, personel tjetër shëndetësor, ose punonjës social.

Roli proaktiv i infermierëve të shkollave në Shqipëri në lidhje me programet e promovimit të shëndetit me fokus të veçantë në nxitjen e sjelljeve të qëndrueshme të shëndetshme tek fëmijët

është pothuajse inekzistent. Prandja shihet e domosdoshme vendosja e një koordinatori shëndeti në çdo shkollë.

Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për përmirësim

Përgjegjësia kryesore e Koordinatorit Shëndetësor, ose ndryshe “Oficeri Ndërlidhës Shëndetësor”, konsiston në një bashkëpunim të ngushtë dhe proaktiv me të gjithë stafin përkatës të shkollës, këshillin e prindërve, strukturat drejtuese të fëmijëve, pushtetin vendor, zyrën arsimore vendore, njësinë vendore të kujdesit shëndetësor, organizatat e shoqërisë civile dhe komunitetin e përgjithshëm për zbatimin në kohë dhe me efektivitet të planeve vjetore të punës në lidhje me të gjitha ndërhyrjet dhe programet për promovimin e shëndetit të parashikuara në nivel shkolle.

Ekziston një nevojë urgjente për të lidhur në kohë dhe në mënyrë efektive të gjithë sektorët përkatës dhe për të vendosur fëmijët në qendër. Institucionet publike shëndetësore dhe arsimore u shërbejnë të njëjtëve fëmijë, por ka nevojë për për të bashkëpunuar ngushtë me njëri-tjetrin dhe për të zbatuar ndërhyrje cilësore dhe efikase ku në qendër të jenë gjithmonë fëmijët.

Për të arritur këtë qëllim, shkolla ka nevojë për një koordinator që të ndërlidhë, të ndajë përvojat dhe të promovojë shëndetin brenda mjediseve të shkollës dhe gjithashtu përtej mjedisit shkollor.

ii Synimi i projektit

Fuqizimi i rolit të koordinatorit të shëndetit në shkolla synon promovimin e sjelljeve të shëndetshme në mënyrë të drejtpërdrejtë tek fëmijët dhe, përmes tyre, transmetimin e praktikave të shëndetshme tek prindërit dhe komunitetet në tërësi

**iii Aktivitetet kryesore të projektit**

Caktimi i një “Koordinatori Shëndeti” në shkollë.

**b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)**

Çdo shkollë të ketë një koordinatorë shëndeti.

Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda) - ZVAP - Drejtori i IA	Kontributet e mundshme në projekt (institucione qëndrore, OJF, donator, etj)
---	--

## 2.2 Shëndeti dhe mirëqenia si pjesë e planeve të shkollës

- Shëndeti fizik dhe mirëqenia e fëmijëve
- Promocioni i shëndetit dhe mirëqenies si pjesë e qëllimeve edukuese të shkollës
- Promocioni i shëndetit dhe mirëqenies së nxënësve si pjesë e kurrikulës shkollore
- Vizioni i shkollës mbi shëndetin dhe mirëqenien e nxënësve
- Nxënësit, stafi mësimor/ndihmës nxiten të marrin pjesë në planifikimin dhe zbatimin e aktiviteteve shkollore që lidhen me shëndetin dhe mirëqenien
- Shkolla ka protokolle të qarta në rastet e shpërthimeve epidemike apo fatkeqsive të ndryshme

### 2.2.1 Qëllimi kryesor

#### Qëllimi kryesor:

Qëllimi kryesor është përfshirja e aktiviteteve me synim promocionin shëndetësor në shkollë.

### 2.2.2 Nën-Objektiva

- ✚ **Nën-Objektivi 1:** Përfshirja e aktiviteteve kros/ekstrakurrikulare me fokus shëndetin.
- ✚ **Nën-Objektivi 2:** Përfshirja në planin vjetor e aktiviteteve që lidhen me sjelljet e shëndetshme.
- ✚ **Nën-Objektivi 3:** Zhvillimi i sondazheve që reflektojnë qartësisht dëshirat dhe nevojat shëndetësore të nxënësve.
- ✚ **Nën-Objektivi 4:** Trajnimi i stafit mbi protokollet në rastet e shpërthimeve epidemike apo fatkeqsive të ndryshme (tërmetet, zjarret, përmytjet etj).

### 2.2.3 Indikatorët e Performancës

Indikatorët e Performancës		
Matja e Indikatorëve të Performancës	Fakt 2022	Plan 2023
Numri i aktiviteteve kros-ekstra-kurrikulare të zhvilluara nga shkollat në kuadër të promocionit shëndetësor.		
Përqindja e shkollave që zhvillon sondazhe që reflektojnë qartësisht dëshirat dhe nevojat e nxënësve.		
Përqindja e stafit që trajnohen mbi shpërthimet epidemike apo fatkeqesi të ndryshme (tërmetet, zjarret, përmytjet etj)		

Shkollat kanë protokolle për emergjencat, rastet e shpërthimeve epidemike apo fatkeqsive të ndryshme (tërmetet, zjarret, përmbytjet etj)		
--	--	--

#### 2.2.4 Lista e veprimeve

Nr.	Nën-objektivi	Veprimi	Përgjegjës
1.	Përfshirja e aktiviteteve kros dhe ekstrakurrikulare me fokus promocionin e shëndetit.	Propozim i shtimit në Planin vjetor të kalendarit të aktiviteteve mbi shtimin e aktiviteteve me fokus promocionin shëndetësor.	ZVA-ja Drejtori i IA
2.	Zhvillimi i sondazheve që reflektojnë qartësisht dëshirat dhe nevojat shëndetësore të nxënësve	Kryerja e sondazheve nga psikologu/punonjësi social	Drejtori i IA Psikologu/ punonjësi social
3.	Trajnim i stafit mbi protokollin në rastet e shpërthimeve epidemike apo fatkeqsive të ndryshme (tërmetet, zjarret, përmbytjet etj)	Trajnim me donatorë ose në bashkëpunim me institucionet përkatëse, emergjencat civile, njësitë vendore të shëndetit publik etj.	Drejtori IA Donatorë, emergjencat civile ose NJVKSH-ja

#### 2.2.5 Lista e projekteve

<b>Nr. 1</b>	<b>Projekti:</b> Zhvillimi i trajnimeve për protokollin në rastet e shpërthimeve epidemike apo fatkeqsive të ndryshme (tërmetet, zjarret, përmbytjet etj)
<b>a)Përshkrim i shkurtër i projektit:</b>	
<b>i. Situata:</b>	
Shkolla ka protokolle në raste shpërthimesh epidemike apo fatkeqsive të ndryshme, por stafi i shkollës nuk trajnohet për këto protokolle.	
Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për përmirësim	
Stafi mësimor i shkollës nuk kanë zhvilluar trajnime mbi protokollin në rastet e shpërthimeve epidemike apo fatkeqsive të ndryshme (tërmetet, zjarret, përmbytjet etj). Trajnimet ju japin mundësi drejtuesve dhe mësuesve të identifikojnë rreziqet që i kanosen nxënësve nga rastet emergjente që mund të ndodhin në shkollë për shkak të rasteve nga zjarri, përmbytjet dhe nga	

tërmeti. Drejtuesi i shkollës dhe mësuesit i bëjnë pjesë nxënësit në planifikimin dhe zhvillimin e kurrikulës, si dhe të proceseve vendimmarrëse që lidhen me sigurinë e tyre.

Gjithashtu trajnimi i jep mundësi drejtuesit të institucionit të krijojnë aftësi për monitorimin dhe vlerësimin e punës që kryhet në shkollë për kujdesin dhe ruajtjen në raste emergjente.

## ii Synimi i projektit

Rritje kapaciteti të stafit të shkollës për menaxhimin e emergjencave synon ta shndërrojë shkollën në një komunitet të nxëni të orientuar drejt krijimit të një kulture të sigurisë institucionale.

## iii Aktivitetet kryesore të projektit

Zhvillimi i trajnimeve mbi protokollet e shpërthimve epidemike apo fatkeqsive të ndryshme me stafin e shkollës.

## b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)

Në përfundim të këtij trajnimi pjesëmarrësit do të jenë të aftë të:

- identifikojnë rastet emergjente që ndodhin për shkak të përmytjeve, zjarrit dhe tërmetit;
- shpjegojnë rëndësinë që ka mbrojtja dhe sigurimi nga rreziqet emergjente që lidhen me përmytjet dhe zjarrin;
- identifikojnë mjedisin fizik të shkollës, elementet e saj, mjedisin përreth shkollës që pengojnë ose mundësojnë raste emergjente që lidhen me zjarrin dhe përmytjet;
- shqyrtojnë masat që duhen marrë në kushtet e shtëpisë dhe të shkollës për t'u ruajtur nga zjarri, përmytja dhe tërmeti;
- hartojnë një plan trajnimi për nxënësit për rastet e shpëtimit nga zjarri, tërmeti dhe përmytjet;
- vlerësojnë punën edukative për krijimin e aftësive të nxënësve për t'u ruajtur nga rastet emergjente si zjarri, përmytjet dhe tërmeti.

Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda)	Kontributet e mundshme në projekt (institucione qëndrore, OJF, donator, etj)
Drejtori i IA	Donator, OJF etj.

**e) Shpenzimet e llogaritura** (për cdo aktivitet të mësipërm pika iii)

Shpenzimet për cdo aktivitet	Totali (mijë lekë)
Shuma:	
<b>f) Periudha e zbatimit:</b> Viti akademik 2023-32024	<b>g) Ndjek zbatimin e projektit:</b> ZVAP

<b>Nr. 2</b>	<b>Projekti:</b> Hartimi i kalendarit të aktiviteteve
<b>a) Përshkrim i shkurtër i projektit:</b> Projekti “Shkollat për Shëndetin” ka hartuar një “Udhëzues për kalendarin e aktiviteteve në institucionet arsimore parauniversitare”. Në këtë udhëzues jepen shembuj konkretë të veprimtarive mbi sjelljet e shëndetshme në nivel shkolle ose në nivel klase. Gjithashtu në fund të udhëzuesit do të ketë modele të planeve të veprimtarive plotësuese dhe jashtëshkollore për tema specifike.	
<b>i. Situata:</b>  Shkollat nuk përfshijnë mjaftueshëm aktivitete që nxisin sjelljet e shëndetshme në planin e tyre të veprimtarive.	
Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për përmirësim	
Praktikimi i sjelljeve të shëndetshme që në moshë të hershme, u mundëson nxënësve një vazhdimësi të praktikimit të tyre edhe përtej shkollës. Edukimi i vazhdueshëm i nxënësve mbi sjelljet e shëndetshme, sikurse përgatitja e stafit të shkollës, duhet të jenë një proces i planifikuar mirë.	
Udhëzuesi përshkruan njohuritë e nevojshme që i nevojiten një drejtuesi shkolle për të përfshirë në planin e veprimtarive plotësuese dhe jashtëshkollore edhe sjelljet e shëndetshme, duke përfshirë zakonet e shëndetshme të ushqyerjes, aktivitetin fizik, parandalimin e përdorimit të duhanit, alkoolit dhe drogave, promovimin e shëndetit seksual, mendor si dhe praktikatat e mira higjienike dhe masat efektive për parandalimin e sëmundjeve infektive, përfshirë këtu edhe COVID-19.	

Aktivitetet e propozuara janë gjithëpërfshirëse në mënyrë që të vihen në zbatim nga të gjitha shkollat, pavarësisht infrastrukturës dhe kapaciteteve të secilës prej tyre. Këto aktivitete kanë qasje praktike, duke patur në qendër nxënësit, prindërit dhe sjelljet e shëndetshme.

**ii Synimi i projektit**

- Zhvillimi i veprimtarive të planifikuara për praktikimin e sjelljeve të shëndetshme në shkollë.
- Ndërgjegjësimi i komunitetit të zonës për praktikimin e sjelljeve të shëndetshme në shkollë.
- Krijimi i një kulture bashkëpunimi të nxënësve, mësuesve dhe pjesës tjetër të stafit mësimor, prindërve dhe anëtarëve të tjerë të komunitetit.

**iii Aktivitetet kryesore të projektit**

Disa aktivitete/veprimtari që zhvillohen në kuadër të promocionit shëndetësor janë:

20 shtator- Higjiena personale dhe parandalimi i sëmundjeve infektive.

10 tetori-Dita botërore e shëndetit mendor

17 tetor- Dita botërore e urisë

26 tetor- Të ushqyerit e shëndetshëm

10 janar- Edukimi seksual gjithëpërfshirës

2 prill- Dita botërore e autizmit

7 prill- Dita Botërore e Shëndetit

8-12 Maj- Java olimpike etj.

**b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)**

Shtimi i aktiviteteve të propozuara në planin vjetor të veprimtarive të shkollave.

<p>Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda)</p> <p>ZVA</p> <p>Drejtori i IA</p>	<p>Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj)</p>
---	---

**f) Periudha e zbatimit:**

**g) Ndjek zbatimin e projektit:**

## 2.3 Mjedisi fizik në shkollë

- Mjediset shkollore janë “miqësore” për fëmijët, të sigurta, të pastra dhe nxisin higjenën personale për të gjithë nxënësit
- Mjediset shkollore janë të përshtatshme për nxënësit, sipas moshës dhe gjinisë, si dhe për nxënësit me aftësi të kufizuara
- Mjediset shkollore janë të hapuar për aktivitete pas orëve të mësimi
- Mjediset shkollore mundësojnë distancimin fizik
- Përbushja e standardeve zyrtare të mjediseve shkollore
- Siguria përreth dhe brenda shkollës
- Ventilimi (ajrosja), ndriçimi dhe temperatura e mjediseve shkollore
- Pijet dhe ushqimet e shëndetshme në mjediset e shkollës

### 2.3.1 Qëllimi kryesor

#### **Qëllimi kryesor:**

Përmirësimi i mjediseve fizike të shkollës për fëmijët, duke garantuar siguri, higjenë dhe përmushjen e kushteve të nevojshme për të nxënë.

### 2.3.2 Nën-Objektiva

- ✚ **Nën-Objektivi 1:** Ofrimi i mjediseve të sigurta dhe miqësore për nxënësit
- ✚ **Nën-Objektivi 2:** Përdorimi i mjediseve të shkollës për fëmijët e komunitetit, pas orarit mësimor
- ✚ **Nën-Objektivi 3:** Klasat e profilizuar në sport.

### 2.3.3 Indikatorët e Performancës

<b>Indikatorët e Performancës</b>		
<b>Matja e Indikatorëve të Performancës</b>	<b>Fakt 2022</b>	<b>Plan 2023</b>
A lejohet përdorimi i mjediseve të shkollës pas orarit mësimor, për nxitjen e aktivitetit fizik.		
A janë krijuar klasa sportive.		
Përqindja e nxënësve që përfitojnë nga klasat sportive.		
Përqindja e djemve që kanë marrë pjesë në klasat sportive.		
Përqindja e vajzave që kanë marrë pjesë në klasat sportive.		
Përqindja e nxënësve me aftësi të kufizuar që kanë marrë pjesë në klasat sportive.		
Përqindja e nxënësve rom/egjiptian që kanë marrë pjesë në klasat sportive.		

#### 2.3.4 Lista e veprimeve

<b>Nr.</b>	<b>Nën-objektivi</b>	<b>Veprimi</b>	<b>Përgjegjës</b>
1.	Përdorimi i mjediseve të shkollës për fëmijët e komunitetit, pas orarit mësimor	Hartimi i një plani për shfrytësimin e ambjenteve sportive të shkollës bashkë me mësuesit e lëndës së edukimit fizik.	Drejtori i IA Mësuesit e lëndës edukim fizik
2.	Hapja e klasave të profilizuar në sport.	Raportimi i aktiviteteve që kryejnë klasat sportive dhe i numrit të nxënësve që përfitojnë na këto klasa.	Mësuesit e lëndës edukim fizik

#### 2.3.5 Lista e projekteve

<b>Nr. 1</b>	<b>Projekti:</b> Raportimi i aktiviteteve që kryejnë klasat sportive dhe i numrit të nxënësve.
<b>a) Përshkrim i shkurtër i projektit:</b>	

<p>Nëse shkolla nuk ka klasa të profilizuara në sport, duhet ti krijojnë për sporte të ndryshme si gjimnastikë, atletikë etj. Numri i nxënësve që marrin pjesë duhet të raportohet sëbashku me një përshkrim të aktivitetit të zhvilluar.</p>	
<p><b>i Situata:</b></p> <p>Vihet re një rënie e numrit të shkollave ku janë hapur dhe funksionojnë klasat e profilizuara në sport, kjo si rrjedhojë e situatës së krijuar nga tërmeti i nëntorit 2019.</p>	
<p>Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për përmirësim</p>	
<p>Hapja e klasave të profilizuara në sport, duhet realizua në mbështetje të urdhrin nr. 440, datë 2.05.2018 “Për hapjen e klasave të profilizuara në sport në shkollat e arsimit bazë të sistemit parauniversitar”.</p> <p>Duhet raportuar numri i nxënësve që janë pjesë e këtyre aktiviteteve, si dhe tematikën e aktiviteteve.</p>	
<p>ii Synimi i projektit</p> <p>Të përfshihen dhe të përfitojnë sa më shumë nxënës nga klasat sportive, duke i nxitur të zhvillojnë sa më shumë aktivitetin fizik.</p>	
<p><b>iii Aktivitetet kryesore të projektit</b></p> <p>Raportimin i nxënësve që përfitojnë dhe marrin pjesë në klasat sportive.</p>	
<p><b>b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)</b></p> <p>Përfshirja e 80% të nxënësve në shkollat që kanë klasa sportive.</p>	
<p>Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda)</p>	<p>Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj)</p>
<p><b>f) Periudha e zbatimit:</b></p>	<p><b>g) Ndjek zbatimin e projektit:</b></p>

<p><b>Nr. 2</b></p>	<p><b>Projekti:</b> Hartimi i një plani për shfrytësimin e ambjenteve sportive të shkollës.</p>
<p><b>a) Përshkrim i shkurtër i projektit:</b></p>	

Nëse shkolla ka ambiente sportive, palestra apo fusha për të luajtur mund të hartojnë një plan sëbashku me mësuesit e lëndës së edukimit fizik për të shfrytëzuar pas orarit të mësimit.

**i. Situata:**

Shumë shkolla nuk i shfrytëzojnë mjediset sportive për nxënësit dhe për fëmijët e komunitetit përreth.

Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për përmirësim

Bazuar në ligjin Nr. 18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”, sipas Nenit 19 mbi të drejtën për pushim dhe argëtime kulturore e sportive, citohet:

- krijimin e hapësirave të përshtatshme për të mundësuar ushtrimin e sigurt dhe gjithëpërfshirës të veprimtarive sportive, kulturore e dëfryese në mjediset shkollore dhe komunitare;
- hartimin e kurrikulave shkollore, të cilat krijojnë mundësi që fëmijët të kenë kohë të mjaftueshme për lojëra, çlodhje dhe veprimtari sportive.

Shkolla duhet të funksionojë si një qendër, ku nxënësit të mësojnë rreth bashkëpunimit dhe shërbimeve të përbashkëta, ku komuniteti të forcojë identitetin e tij dhe nivelin e konsensusit.

Zakonisht fushat e sportit, palestra, biblioteka, laborator i informatikës, janë në dispozicion të komunitetit sipas disa kufizimeve specifike. Shkolla duke i shërbyer një mase të gjërë publiku, organizatave të shoqërisë civile, organizmave privat, mundëson shfrytëzimin e hapësirave për takime dhe aktivitete publike apo private, argëtim, rekreacion, pas mbarimit të orarit zyrtar të mësimit.

**ii Synimi i projektit**

Motivimi dhe nxitja e nxënësve të shkollës dhe të komunitetit përreth shkollës, për të zhvilluar aktivitet fizik jashtë orarit mësimor, në mënyrë që të qëndrojnë të shëndetshëm.

Kjo strategji nxit bashkëpunimin, të mësuarin ndërdisiplinar dhe krijimin e projekteve, i angazhojnë nxënësit të lëvizin, të punojnë në grup dhe të jenë aktiv.

**iii Aktivitetet kryesore të projektit**

Hartimi i një plani për shfrytësimin e ambienteve sportive nga drejtori i shkollës me mësuesit e lëndës së edukimit fizik, kundrejt një pagese simbolike nga fëmijët që do shfrytëzojnë mjediset e shkollës. Gjithashtu duke marrë leje në Bashki, konfort me ligjin.

**b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)**

Kjo marrëdhënie dypalëshe e shkollës me komunitetin do të sillte përfitime duke krijuar një fond të veçantë, që mund të shërbente për mirëmbajtjen e shkollës dhe zhvillimin e aktiviteteve të nxënësve.

<p>Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda)</p> <p>Drejtori i IA</p> <p>Mësuesi i edukimit fizik dhe shëndet</p>	<p>Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj)</p> <p>Bashkia</p> <p>Komuniteti</p>
<p><b>e) Shpenzimet e llogaritura</b> (për cdo aktivitet të mësipërm pika iii)</p>	
<p><b>Shpenzimet për cdo aktivitet</b></p>	<p><b>Totali (mijë lekë)</b></p>
<p>Shuma:</p>	
<p><b>f) Periudha e zbatimit:</b></p>	<p><b>g) Ndjek zbatimin e projektit:</b></p>

## 2.4 Mjedisi social në shkollë

- Projektimi i mjediseve të shkollës
- Aktivitetet e ofruara nga shkolla që kanë si qëllim edhe promovimin e shëndetit dhe mirëqenien e nxënësve
- Përfshirja në programet jashtë-shkollore të aktiviteteve edukuese dhe promovuese të shëndetit
- Atmosfera miqësore në shkollë
- Prania e një individi të besuar për nxënësit
- Punonjësi shëndetësor në shkollë
- Mbështetja për nxënësit me aftësi të kufizuara
- Identifikimi dhe referimi i nxënësve me aftësi të kufizuara

### 2.4.1 Qëllimi kryesor

#### **Qëllimi kryesor:**

Shkolla ka si qëllim promovimin e shëndetit dhe mirëqenien e nxënësve. Shndërrimi i shkollës në mjedis miqësor dhe jo abuzuese për fëmijët.

### 2.4.2 Nën-Objektiva

- ✚ **Nën-Objektivi 1:** Sigurimi i një mjedisi miqësor për fëmijët
- ✚ **Nën-Objektivi 2:** Përfshirja në programet jashtë-shkollore të aktiviteteve edukuese dhe promovuese të shëndetit
- ✚ **Nën-Objektivi 3:** Përfshirja e nxënësve me aftësi të kufizuara në shkollë në aktivitete edukuese dhe promovuese të shëndetit

### 2.4.3 Indikatorët e Performancës

<b>Indikatorët e Performancës</b>		
<b>Matja e Indikatorëve të Performancës</b>	<b>Fakt 2022</b>	<b>Plan 2023</b>
Përqindja e nxënësve që marrin pjesë në aktivitete edukuese dhe promovuese të shëndetit.		
Përqindja e djemve që kanë marrë pjesë në aktivitete edukuese dhe promovuese të shëndetit.		
Përqindja e vajzave që kanë marrë pjesë në aktivitete edukuese dhe promovuese të shëndetit.		

Përqindja e nxënësve me aftësi të kufizuara që kanë marrë pjesë në aktivitete edukuese dhe promovuese të shëndetit.		
Përqindja e nxënësve rom/egjiptian që kanë marrë pjesë në aktivitete edukuese dhe promovuese të shëndetit.		

#### 2.4.4 Lista e veprimeve

Nr.	Nën-objektivi	Veprimi	Përgjegjës
1.	Sigurimi i një mjedisi miqësor për fëmijët	Sigurimi i një atmosfere miqësore dhe të sigurt për fëmijët.	Drejtori i IA ZVAP

#### 2.4.5 Lista e projekteve

<b>Nr. 1</b>	<b>Projekti:</b> Shkolla si mjedis miqësor për fëmijët
<b>a) Përshkrim i shkurtër i projektit:</b>	
Organizimi i hapësirave shkollore është aspekt shumë i rëndësishëm në sigurimin e ambientit të sigurt dhe jo-abuzues për fëmijët. Pra, si është e organizuar ndërtesa, si është e organizuar brenda klasa, ambienti i jashtëm i shkollës, ndriçimi etj.	
<b>i Situata:</b>	
Ka shkolla të cilat nuk kanë ndriçim të mirë, banjat nuk kanë shul por janë me çelës dhe rrezikojnë ngecjen e nxënësve brenda. Jo të gjitha shkollat kanë hapësira ku nxënësit mund të marrin shërbime, të zhvillojnë aktivitete në mjedise të hapura pa pengesa.	
Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për përmirësim	
Mjedisi miqësor, i sigurt, i pa-dhunshëm dhe jo diskriminues nënkupton krijimin e klimës pozitive në shkollë që kontribuon drejtpërdrejt në zhvillimin fizik, social, emocional për të gjithë fëmijët. Për më tepër klima pozitive shkollore mund të çojë në ulje të mungesave, të shërbejë si një metodë e parandalimit të dukurive negative dhe të zvogëlojë efektet e pabarazive socio-ekonomike. Shkollat mjedis të tillë, minimizojnë rastet e dhunës, ka më pak ngacmim dhe arrijnë rezultate më të mëdha akademike.	
ii Synimi i projektit	

Krijimi i ambienteve të sigurta, jo-abuzues, atraktiv dhe stimulues që sigurojnë mirëqenie për fëmijët.

### **iii Aktivitetet kryesore të projektit**

#### **1. Mënyra e organizimit të hapësirave shkollore**

- Të gjitha hapësirat shkollore (klasat, korridoret, parkingjet dhe oborri i shkollës) duhet të jenë mirë të ndriçuara dhe dukshmëria është e mjaftueshme për stafin e shkollës që t'i mbikëqyrë të gjitha hapësirat me lehtësi.

- Dyert e tualeteve duhet të jenë të tilla që mund të hapen nga brenda pa çelës. Kjo parandalon mbylljen e fëmijëve në tualete.

- Nuk ka perde që pengojnë shikimin e hapësirave në të cilat fëmijët marrin shërbime apo hapësira ku dikush mund t'i çojë fëmijët.

### **c) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)**

Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda) Drejtori i IA	Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj)
---	--

### **d) Periudha e zbatimit:**

### **g) Ndjek zbatimin e projektit:**

## 2.5 Nxitja e aftësive për përmirësimin e shëndetit

- Shkolla zbaton programe që nxisin zhvillimin e aftësive individuale dhe përvetësimin e njohurive mbi shëndetin
- Shkolla ka rregulla të qarta që nxisin sjellje të shëndetshme

### 2.5.1 Qëllimi kryesor

**Qëllimi kryesor:** Të nxiti aftësitë e nxënësve për të përmirësuar shëndetin në shkollë.

### 2.5.2 Nën-Objektiva

✚ **Nën-Objektivi 1:** Zhvillimi i aktiviteteve për edukimin bashkëmoshatar (peer-to-peer education) ku nxënësit edukojnë një-tjetrin.

✚ **Nën-Objektivi 2:** Hartimi i rregullores që nxit sjellje të shëndetshme.

### 2.5.3 Indikatorët e Performancës

Indikatorët e Performancës		
Matja e Indikatorëve të Performancës	Fakt 2022	Plan 2023
Përqindja e nxënësve që marrin pjesë në aktivitetet e edukimit bashkëmoshatar		
Përqindja e djemve që kanë marrë pjesë në aktivitetet e edukimit bashkëmoshatar		
Përqindja e vajzave që kanë marrë pjesë në aktivitetet e edukimit bashkëmoshatar.		
Përqindja e nxënësve me aftësi të kufizuara që kanë marrë pjesë në aktivitetet e edukimit bashkëmoshatar.		
Përqindja e nxënësve rom/egjiptian që kanë marrë pjesë në aktivitetet e edukimit bashkëmoshatar.		
Hartimi i një rregulloreje mbi sjelljet e shëndetshme në shkollë		

#### 2.5.4 Lista e veprimeve

Nr.	Nën-objektivi	Veprimi	Përgjegjës
1.	Zhvillimi i aktiviteteve për edukimin bashkëmohatar (peer-to-peer education) ku nxënësit edukojnë një-tjetrin.	Mësuesit organizojnë nxënësit, për të zhvilluar aktivitete ku nxënësit kryejnë edukim bashkëmohatar.	Mësuesit dhe nxënësit
2.	Shkolla ka një rregullore që nxit nxënësit drejt sjelljeve të shëndetshme.	Hartimi i rregullores që nxit sjellje të shëndetshme në shkollë.	Drejtori i IA, mësuesit dhe nxënësit

#### 2.5.5 Lista e projekteve

<b>Nr. 1</b>	<b>Projekti:</b> Edukimi bashkëmohatar (peer-to-peer education)
<b>a) Përshkrim i shkurtër i projektit:</b>	
Edukimi mes bashkëmohatarëve mbështetet në idenë se “të rinjtë janë ekspertë të jetës së tyre dhe për këtë arsye janë pikënisja më e mirë në çdo proces mësimor”.	
<b>i. Situata:</b>	
Në shkolla nuk janë zhvilluar orë ku nxënësit të jenë edukuesit e bashkëmohatarve të tyre mbi sjelljet e shëndetshme. Mësuesit janë ata që shpjegojnë dhe ndajnë informacionin me nxënësit.	
Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për përmirësim	
Një ndër format më të mira për të mësuar mbi sjelljet e shëndetshme është nëpërmjet përvojave nga njëri-tjetri, në këtë mënyrë nxënësit bëhen edukatorë të bashkëmohatarëve dhe inkurajohen që t’ua përcjellin informacionin të tjerëve në mënyrë që të gjenerojnë ndryshim midis anëtarëve të tjerë të të njëjtit grup.	
<b>ii Synimi i projektit</b>	
Të edukojmë fëmijët mbi sjelljet e shëndetshme nëpërmjet përvojave dhe eksperiencave të ndara midis njëri-tjetrit.	
<b>iii Aktivitetet kryesore të projektit</b>	
Organizimi i nxënësve pas orës mësimore ose gjatë orëve të lira, me ndihmën e mësuesve, për të zhvilluar temat mbi sjelljet e shëndetshme. Gjatë këtyre orëve nxënësit do të shpjegojnë, do	

të japi informacion dhe përvoja të tyre mbi sjelljet e shëndetshme dhe promovimin e shëndetit në shkollë.

**b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)**

Rritje të kapaciteteve dhe njohurive të nxënësve mbi sjelljet e shëndetshme dhe promovimin e shëndetit nëpërmjet edukimit bashkëmohatar. Si dhe një përfshirje të madhe të nxënësve në këto aktivitete.

<b>Nr. 2</b>	<b>Projekti:</b> Hartimi i rregullores që nxit sjellje të shëndetshme
<b>a) Përshkrim i shkurtër i projektit:</b> Për hartimin e rregullores duhet të bashkëpunojnë disa aktorë si mësuesit, punonjësit social/psikologë, komisioni i shëndetit, oficeri i sigurisë, qeveria e nxënësve dhe këshilli I prindërve të shkollës etj.	
<b>i. Situata:</b> Në shumicën e shkollave mungon një rregullore e dedikuar sjellejeve të shëndetshme, e cila ndalojë dukurit jo të shëndetshme (si dhuna, abuzimi etj) dhe nxit fëmijët drejt promovimit të shëndetit.	
Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për përmirësim	
Shkolla gjatë hartimit të rregullores duhet të ketë parasysh pikat e mëposhtme: <ul style="list-style-type: none"><li>• rregullat e sjelljes që ndalojnë dukuritë jo të shëndetshme dhe vazhdimisht e monitoron zbatimin e tyre</li><li>• duhet të sigurojnë zbatimin e kësaj rregullore e cila përcakton detyrat dhe përgjegjësitë e secilit individ që frekuenton shkollën</li><li>• duhet të realizojë aktivitetet jashtë-kurrikulare, si: ligjërata, debate, aktivitete artistike me temë kundër dhunës, abuzimit dhe promovimit të sjellejeve të shëndetshme.</li></ul>	
<b>ii Synimi i projektit</b> Shkolla duhet të ketë një rregullore e cila të ndaloj dhunën dhe abuzimin midis nxënësve si dhe të nxisi sjelljet e shëndetshme, si psh ndalimi i konsumit të pijeve të gazuara apo me sheqer në ambientet e shkollës.	
<b>iii Aktivitetet kryesore të projektit</b> Bashkëpunimi i aktorëve kryesorë për të hartuar rregulloren.	
<b>b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)</b> Nxënësit duke zbatuar rregulloren do të priren drejt sjellejeve të shëndetshme, dhe mësuesit do e kenë më të thjhtë monitorimin e tyre.	

Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda) Nxënësit, mësuesit.	Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj)
---	--

## 2.6 Lidhja e shkollës me komunitetin e prindërve dhe më gjerë

- Pjesëmarrja dhe përfshirja e prindërve
- Lidhja e shkollës me biznese lokale, klube sportive lokale, dhe me Njësitë Vendore të Kujdesit Shëndetsor
- Organizimi i vizitave tek bizneset lokale për të forcuar sjelljet e shëndetshme

### 2.6.1 Qëllimi kryesor

#### Qëllimi kryesor:

Përfshirja e prindërve dhe më gjerë në aktivitetet që zhvillon shkolla mbi promovimin e sjelljeve të shëndetshme.

### 2.6.2 Nën-Objektiva

- ✚ **Nën-Objektivi 1:** Krijimi i Bordit të Prindërve në çdo shkollë dhe pjesëmarrja aktive e prindërve në çdo aktivitet që zhvillon shkolla.
- ✚ **Nën-Objektivi 2:** Lidhja e shkollës me NJVKSH-të për zhvillimin e aktiviteteve mbi sjelljet e shëndetshme.
- ✚ **Nën-Objektivi 3:** Organizimi i aktiviteteve në komunitet për të forcuar sjelljet e shëndetshme.

### 2.6.3 Indikatorët e Performancës

Indikatorët e Performancës		
Matja e Indikatorëve të Performancës	Fakt 2022	Plan 2023
Përqindja e shkollave që kanë Bordin e Prindërve funksional.		
Numri i aktiviteteve që NJVKSH ka zhvilluar me shkollat.		
Numri i aktiviteteve që janë organizuar në komunitet për të forcuar sjelljet e shëndetshme.		

Përqindja e djemve që kanë marrë pjesë në aktivitetet në komunitet.		
Përqindja e vajzave që kanë marrë pjesë në aktivitetet në komunitet.		
Përqindja e nxënësve që kanë marrë pjesë nga zona urbane dhe nga zona rurale.		
Përqindja e nxënësve që kanë marrë pjesë në aktivitetet në komunitet nga zona urbane.		
Përqindja e nxënësve me aftësi të kufizuar që kanë marrë pjesë në aktivitetet në komunitet.		
Përqindja e nxënësve rom/egjiptian që kanë marrë pjesë në aktivitetet në komunitet.		

#### 2.6.4 Lista e veprimeve

Nr.	Nën-objektivi	Veprimi	Përgjegjës
1.	Krijimi i Bordit të Prindërve në çdo shkollë dhe pjesëmarrja aktive e prindërve në çdo aktivitet që zhvillon shkolla.	Shkollat ngrënë Bordin e prindërve dhe marrin pjesë në aktivitet që shkolla zhvillon me fokus sjelljet e shëndetshme	Drejtori i IA Prindërit
2.	Lidhja e shkollës me NJVKSH-të për zhvillimin e aktiviteteve mbi sjelljet e shëndetshme.	Shkolla bashkëpunon me NJVKSH për organizimin e aktiviteteve me fokus shëndetin	Drejtori i IA NJVKSH-ja
3.	Organizimi i aktiviteteve në komunitet për të forcuar sjelljet e shëndetshme	Shkolla bashkëpunon me komunitetin përreth, biznese, klube sportive etj për të organizuar aktivitete për të nxitur nxënësit të qëndrojnë të shëndetshëm.	Drejtori i IA Komuniteti

#### 2.6.5 Lista e projekteve

<b>Nr. 1</b>	<b>Projekti:</b> Krijimi i Bordit të Prindërve në çdo shkollë dhe pjesëmarrja aktive e prindërve në çdo aktivitet që zhvillon shkolla.
<b>a) Përshkrim i shkurtër i projektit:</b>	
Pasi ngrihet Bordi i Prindërve në çdo shkollë, zhvillohet një takim ku diskutohet dhe merret mendimi i prindërve mbi aktivitetet që ata mund të kontribuojnë me fokus shëndetin.	

<b>i Situata:</b>	
Bordi i Prindërve është i ngritur në shumicën e shkollave, por nuk merr pjesë në zhvillimin e aktiviteteve me fokus shëndetin e fëmijëve.	
Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për përmirësim	
Bordi i Prindërve pasi ngrihet, duhet të zhvillojë minimumi 3 mbledhje në vit, ku prindërit të jetë pjesmarrës aktiv në të gjitha aktivitetet që shkolla zhvillon me fokus shëndetin. Pjesë e bordit duhet të jetë një anëtar nga komuniteti, gjatë përzgjedhjes së këtij anëtari, mund ti jepet prioritet një personi që mund të jetë mjek, infermier, psikolog/ punonjës social, policë, zjarrfikës etj, pasi ata mund të ofrohen të zhvillojnë orë të lira me nxënësit mbi sjelljet e shëndetshme	
ii Synimi i projektit	
Angazhimi i prindërve në aktivitetet me fokus shëndetin e fëmijëve.	
<b>iii Aktivitetet kryesore të projektit</b>	
Aktiviteti i parë është ndërtimi i një kalendari aktivitetesh ku prindërit janë pjesmarrës aktiv. Më pas duhet të bëhet raportimi pas çdo aktiviteti ku të detajohet numri i nxënësve që kanë marrë pjesë, gjinia e tyre si dhe etnia.	
<b>b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)</b>	
Numër të lartë të prindërve të përfshirë në aktivitete si dhe përqndje të lartë të fëmijëve që kanë përfituar nga këto aktivitete.	
Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda)	Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj)

<b>Nr. 2</b>	<b>Projekti:</b> Bashkëpunim me NJVKSH për zhvillimin e aktiviteteve mbi sjelljet e shëndetshme.
<b>a) Përshkrim i shkurtër i projektit:</b>	
Shkolla bashkëpunon me NJVKSH për organizimin e aktiviteteve me fokus shëndetin.	
<b>i. Situata:</b>	
NJVKSH-të hartojnë kalendarin e aktiviteteve në shkolla dhe zhvillojnë takime informuese me nxënësit, por këto takime nuk i përfshijnë aktivisht nxënësit në veprimtari për ti aftësuar, prandaj sygjerojmë shtimin e aktiviteteve promovuese të shëndetit, si dhe zhvillimi i fushatave sensibilizuese.	
Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për përmirësim	

Shërbimi shëndetësor në shkolla ka karakter parandalues. Ai ka për qëllim sigurimin e një zhvillimi normal fizik dhe mendor të fëmijëve të shkollës.

Qëllimi kryesor është bashkëpunimi ndërmjet dy institucioneve për përmirësimin e shërbimit shëndetësor në shkolla, nëpërmjet informimit, edukimit, komunimit për përfitimin e sjelljeve të shëndetshme tek fëmijët e moshës 6-16 vjeç.

NJVKSH duhet të bashkëpunojë dhe me psikologun/punonjësin social, stafin mësimor, bordin e shkollës dhe komunitetin, për të zhvilluar aktivitete me fokus sjelljet e shëndetshme.

#### ii Synimi i projektit

Rritja e kapacitetit dhe edukimi i fëmijëve nga stafi i NJVKSH mbi sjelljet e shëndetshme dhe promocionin shëndetësor.

#### iii Aktivitetet kryesore të projektit

Organizimi i aktiviteteve me NJVKSH në bazë të kalendarit të shëndetësisë.

#### c) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)

Numër të lartë aktiviteteve të zhvilluara si dhe përqindje të lartë të fëmijëve që kanë përfituar nga këto aktivitete.

Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda)	Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj)
--	--

#### Nr. 3

**Projekti:** Zhvillimi i aktiviteteve në komunitet për të forcuar sjelljet e shëndetshme-Shkolla Qendër Komunitare

#### a) Përshkrim i shkurtër i projektit:

Shndërrimi i shkollave në vendin ku realizohet partneriteti shkollë, familje dhe komunitet me fokus zhvillimin akademik, social, fizik, dhe emocional të fëmijës duke shfrytëzuar të gjitha burimet që ofron familja dhe komuniteti.

#### i. Situata:

Sistemi jonë arsimor ka nevojë për shkollat komunitare, sepse vëzhgimet e kryera dhe përvoja ka treguar që fëmijët dhe të rinjtë kanë nevojë për më shumë mundësi dhe mbështetje që të kenë sukses në studimet dhe veprimtaritë e tyre brenda dhe jashtë orarit mësimor.

Konkretisht në ZVAP Korçë kemi 19 Shkolla Qendër Komunitare, nga të cilat 3 shkolla ndodhen në zona rural edhe 16 ndodhen në qytet.

Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për përmirësim

Shkollat, familjet dhe komuniteti sot përballen me një sfidë të përbashkët, që është edukimi cilësor për fëmijët e të rinjtë si dhe mundësi për t'iu përgjigjur nevojave të tyre përtej përgatitjes akademike. Fëmijët duhet të njohin dhe të mbajnë qëndrim për çështjet dhe problematikat sociale të komunitetit. Partneriteti me aktorët e tjerë krijon mundësinë e ngritjes dhe realizimit të projekteve me tematika të përbashkëta duke mundësuar gjetjen e rrugëve për zgjidhjen e tyre dhe aftësuar nxënësit për të kontribuar për komunitetet e tyre.

Shkollat, familja dhe komuniteti punojnë së bashku:

- për të ndërtuar strategji të qëndrueshme për fëmijët, të rinjtë dhe familjet
- për të pasuruar dhe nxitur përmes veprimtarive formale dhe jo formale
- për të siguruar një mjedis që ofron dhe integron shërbime për shkollën, familjen dhe komunitetin.

#### ii Synimi i projektit

Shkolla si qendër komunitare synon zhvillimin cilësor të shkollës dhe aftësimin e fëmijëve dhe të rinjve si qytetarë të gatshëm dhe të aftë për të kontribuar në komunitetet e tyre.

#### iii Aktivitetet kryesore të projektit

- Shkolla organizon aktivitete që kanë si qëllim forcimin e marrëdhënieve: komunitet-nxënës-mësues.
- Shkolla ndërgjegjëson komunitetin për rëndësinë e respektimit të diversitetit
- Shkolla në bashkëpunim edhe me sektorët e shëndetit publik ofron kurse për këshillim familjar.
- Shkolla ofron shërbime psikologjike, sociale, ligjore në rast nevojë të komunitetit.
- Shkolla përgatit komunitetin për strategjitë e ndërhyrjeve në rastin e emergjencave natyrore.

#### b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)

Fokusi i shkollave qendër komunitare është të ndihmojë në zhvillimin akademik të fëmijëve dhe të rinjve, angazhimin dhe kontributin qytetar, mbeshtetjen e familjes, shërbimet sociale me fokus sigurinë dhe shëndetin si dhe shërbimet komunitare.

Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda)	Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj)
--	--

Nr. 4	Projekti: Pjesmarrja aktive e komisioni i shëndetit, sigurisë, mirëmbajtjes dhe mjedisit në aktivitete
-------	--

#### d) Përshkrim i shkurtër i projektit:

Organizon veprimtari ndërgjegjësuere me fëmijët, mësuesit dhe prindërit për kushtet e ruajtjes së shëndetit, të sigurisë, mirëmbajtjes së mjedisëve e pajisjeve të institucionit.

<p><b>i Situata:</b>  Bazuar në urdhërin nr. 31 datë 28.01 2020- “Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”, çdo shkollë duhet të ketë të ngritur Komisionin e shëndetit, sigurisë, mirëmbajtjes dhe mjedisit.</p> <p>Shkollat e kanë ngritur Komisionin e shëndetit , por ai nuk është funksional në të gjitha shkollat, për të përmbushur përgjegjësitë e tij.</p>	
<p>Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për përmirësim</p>	
<p>Përgjegjësitë e Komisionit të shëndetit janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Mbikëqyr rregullisht në IA kushtet e ruajtjes së shëndetit, të higjienës, pastërtisë, mjedisit, të sigurisë së fëmijëve dhe punonjësve, si dhe mirëmbajtjen e mjediseve dhe të pajisjeve.</li> <li>• Identifikon nevojat për mirëmbajtje të institucionit.</li> <li>• Përcakton nevojat për ndreqje të vogla, shërbime, zëvendësime të pjesëve për shkak të dëmtimeve.</li> <li>• Propozon procedurat ditore dhe javore të higjienës, pastërtisë dhe mirëmbajtjes së IA-së, të cilat miratohen nga drejtori i institucionit.</li> <li>• Drejton hartimin e rregullores së shëndetit, sigurisë, mirëmbajtjes dhe mjedisit.</li> </ul>	
<p>ii Synimi i projektit</p> <p>Përmbushja e përgjegjësisë dhe pjesëmarrja aktive e Komisionit të shëndetit në aktivitetet me nxënësit dhe komunitetin e prindërve.</p>	
<p><b>iii Aktivitetet kryesore të projektit</b></p> <p>Komisioni i Shëndetit duhet të organizojë veprimtari dhe të ketë pjesëmarrje aktive në aktivitetet që kryen bordi i prindërve dhe NJVKSH-të, me fokus sjelljet e shëndetshme në shkollë.</p>	
<p><b>b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)</b>  Pjesëmarrje e lartë e nxënësve të shkollës të përfshirë në veprimtari ndërgjegjësuese të zhvilluara nga Komisioni i Shëndetit.</p>	
<p>Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda)</p> <p>Anëtarët e Komisionit të shëndetit, sigurisë, mirëmbajtjes.</p>	<p>Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj)</p>

## 2.7 Staf i shkollës

Standardet profesionale të mësuesit janë pohime të cilat harmonizojnë njohuritë dhe të kuptuarin profesional, aftësitë profesionale, si dhe qëndrimet e vlerat profesionale të mësuesit.

Më poshtë janë përmendur 7 standardet të cilat lidhen me angazhimin, interesin dhe përfshirjen e mësuesit në veprimtari trajnuese dhe kualifikuese; me krijimin e një mjedisi gjithëpërfshirës ku secili ndihet i mirëpritur dhe i mirëseardhur; me krijimin e një klime pozitive dhe me përdorimin e teknikave të disiplinimit pozitiv ku fëmijët pranojnë dhe respektojnë njëri-tjetrin; me interesimin e mësuesit për t'u përditësuar me metodologjitë ndërvepruese të mësimdhënies me qëllim zbatimin cilësor të kërkesave të reja kurrikulare; si dhe me krijimin e një atmosfere bashkëpunuese dhe efektive në shkollë ndërmjet drejtuesve, stafit pedagogjik, prindërve dhe përfaqësuesve të komunitetit.

Standardi 1. Angazhimi i mësuesit në zhvillimin e tij profesional

Standardi 2. Zotërimi i përmbytjes së dokumentacionit kurrikular

Standardi 3. Krijimi i një mjedisi gjithëpërfshirës

Standardi 4. Pranimi dhe respektimi i diversitetit

Standardi 5. Përditësimi i metodologjive të mësimdhënies

Standardi 6. Njohja dhe zbatimi i metodave të vlerësimit

Standardi 7. Zbatimi i kodit të etikës

- Shkolla i ofron mësuesve trajnime dhe rritje të kompetencave profesionale në lidhje me promovimin e shëndetit dhe mirëqenies
- Shkolla ka burime të mjaftueshme për të ofruar materiale të përditësuara në lidhje me promovimin e shëndetit dhe mirëqenies
- Shkolla krijon një balancë midis punës dhe jetës private, siguron një ngarkesë pune të përballueshme dhe i ofron mundësi stafit për të diskutuar probleme të ndryshme
- Mësuesve të rinj u ofrohen trajnime për rritjen e tyre profesionale në drejtim të promovimit të shëndetit dhe mirëqenies
- Përballimi i mungesave të personelit dhe ri-integrimi i stafit mësimor
- Shkolla mbështet stafin në arritjen dhe mbajtjen e një mënyre jetese të shëndetshme

### 2.7.1 Qëllimi kryesor

**Qëllimi kryesor:** Rritja e njohurive dhe aftësive të mësuesve për të promovuar sjellje të shëndetshme te nxënësit e moshës 6-16 vjeç.

### 2.7.2 Nën-Objektiva

- ✚ **Nën-Objektivi 1:** Ofrimi i trajnimeve për mësuesit mbi sjelljet e shëndetshme në shkollë.
- ✚ **Nën-Objektivi 2:** Riorganizimi i burimeve njerëzore aktuale, duke patur një qasje sa më gjithëpërfshirëse.

### 2.7.3 Indikatorët e Performancës

<b>Indikatorët e Performancës</b>		
<b>Matja e Indikatorëve të Performancës</b>	<b>Fakt 2022</b>	<b>Plan 2023</b>
Përqindja e mësuesve që janë trajnuar në platformën e-Learning.		
Përqindja e stafit shëndetësor që janë trajnuar për promovimin e sjelljeve të shëndetshme në shkollë.		
Numri i psikologë, punonjës social në shkollë për numër nxënësish.		
Numri i mjekë/infermierë në shkollë për numër nxënësish.		
Numri i oficerë sigurie në shkollë për numër nxënësish.		
Numri i mësuesve ndihmës për numër fëmijësh me aftësi të kufizuara në shkollë.		

### 2.7.4 Lista e veprimeve

<b>Nr.</b>	<b>Nën-objektivi</b>	<b>Veprimi</b>	<b>Përgjegjës</b>
<b>1.</b>	Ofrimi i trajnimeve për mësuesit mbi sjelljet e shëndetshme në shkollë.	Regjistrimi i mësuesve në platformën e-Learning për të zhvilluar trajnime online, si edhe zhvillimi i trajnimeve fizike.	Drejtori i IA ZVAP Projekti “Shkollat për Shëndetin”
<b>2.</b>	Ofrimi i trajnimeve për stafin shëndetësor mbi promovimin e sjelljeve të shëndetshme në shkollë.	Zhvillimi i trajnimeve online ose fizik me stafin shëndetësor të NJVKSH, për të promovuar sjelljet e shëndetshme të nxënësit e moshës 6-16 vjeç	Drejtori i IA Projekti “Shkollat për Shëndetin”
<b>3.</b>	Riorganizimi i burimeve njerëzore aktuale, duke	Mbulimi me aktivitete të promocionit shëndetësor në shkollat e territorit (mjekët/infermierët rakordojnë punën duke i ofruar shërbim një numri të caktuar shkollash, pranë njëra tjetrës, kur ato kanë nevojë).	ZVAP NJVKSH Drejtori i IA

	patur një qasje sa më gjithëpërfshirëse.	Mbulimi me shërbim psiko-social në shkollat e terrorit (punonjësit social/psikologët rakordojnë punën duke i ofruar shërbim një numri të caktuar shkollash, pranë njëra tjetrës, kur ato kanë nevojë).	ZVAP Drejtori i IA
--	--	--	-----------------------

### 2.7.5 Lista e projekteve

<b>Nr. 1</b>	<b>Projekti:</b> Zhvillimi i trajnimeve online në platformën e-Learning
<p><b>a) Përshkrim i shkurtër i projektit:</b> Regjistrimi i mësuesve në platformën e-Learning dhe zhvillimi i moduleve të trajnimit.</p>	
<p><b>i Situata:</b> Sipas udhëzimit Nr.16 datë 28.07.2021 “Për organizimin dhe funksionimin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë” duhet që:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Punonjësit arsimorë të trajnohen 18 orë në vit, të cilat pasqyrojnë 1 kredit.</li> </ul> <p>Jo të gjithë mësuesit arrijnë të plotësojnë normën e 1 krediti në vit.</p>	
Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për përmirësim	
<p>Platforma e-Learning është krijuar për të ardhur në ndihmë stafit mësues, që të kenë mundësi të zhvillojnë trajnime online në çdo kohë.</p> <p>Momentalisht në të janë 5 module trajnimi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Rëndësia e të ushqyerit shëndetshëm në kurrikulën shkollore të grupmoshës 6-16 vjeç.</li> <li>• Rëndësia e aktiviteti fizik dhe shëndeti të nxënësit të moshës 6-16 vjeç, për të promovuar një stil jetese të shëndetshme.</li> <li>• Promovimi i rëndësisë të shëndetit mendor të nxënësit të moshës 6-16 vjeç.</li> <li>• Edukimi seksual gjithëpërfshirës.</li> <li>• Higjiena personale, parandalimi i sëmundjeve infektive të nxënësit të moshës 6-16 vjeç dhe mbrojtja e mjedisit.</li> </ul>	
ii Synimi i projektit	
<p>Synimi i trajnimeve online është përditësimi i njohurive dhe zhvillimi i kompetencave të stafit mësues mbi sjelljet e shëndetshme, në mënyrë që t’ju sigurojë të gjithë nxënësve shërbim arsimor cilësor.</p>	
<b>iii Aktivitetet kryesore të projektit</b>	
<p>Trajnimi i mësuesve se si të aksesojnë platformën e-Learning online, si të regjistrohen në të dhe si të zhvillojnë modulën e trajnimit.</p>	
<b>b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)</b>	

Të gjithë mësuesit të jenë regjistruar në platformën e-Learning për të ndjekur trajnime online.	
Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda)	Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj)
Drejtori i IA dhe mësuesit	Projekti “Shkollat për Shëndetin”

<b>Nr. 2</b>	<b>Projekti:</b> Zhvillimi i trajnimeve online ose fizikisht me stafin shëndetësor të shkollës, për promovimin e sjelljeve të shëndetshme.
--------------	--

**a) Përshkrim i shkurtër i projektit:**

Pjesëmarrja e stafit shëndetësor në trajnimet mbi promovimin e sjelljeve të shëndetshme.

**i. Situata:**

Stafi shëndetësor në shkolla nuk zhvillon trajnime të vazhdueshme për të rritur kapacitetin e tyre rreth promovimit të sjelljeve të shëndetshme në shkollë, prandaj shihet e nevojshme kryerja e trajnimeve.

Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për përmirësim

Mënyra se si transmetohet mesazhi mbi promovimin e sjelljeve të shëndetshme, në grupmoshat e reja është tepër delikat, prandaj zhvillimi i trajnimeve rrit kapacitetet menaxhuese të temave mbi promovimin e sjelljeve të shëndetshme në shkollë.

Stafi shëndetësor aftësohet dhe mund të trajnoj dhe mësuesit për të shtuar tema mbi promovimin shëndetësor në temat mësimore.

**ii Synimi i projektit**

Synimi i trajnimeve online/fizikisht është përditësimi i njohurive dhe zhvillimi i kompetencave të stafit shëndetësor mbi promovimin e sjelljeve të shëndetshme, në mënyrë që të nxisin nxënësit drejt sjelljeve të shëndetshme.

**iii Aktivitetet kryesore të projektit**

Përfshirja e gjithë stafit shëndetësor të shkollës në trajnimet për promovimin e sjelljeve të shëndetshme në shkollë.

**c) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)**

Të gjithë pjestarët e stafit shëndetësor në shkollë të jenë trajnuar rreth promovimit të sjelljeve të shëndetshme në shkollë.

Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda)	Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj)
Drejtori i IA dhe stafi shëndetësor	Projekti “Shkollat për Shëndetin”

## 2.8 Menaxhimi i procesit të promovimit të shëndetit dhe mirëqenies nga shkolla

- ✚ Përfshirja e aktiviteteve në planet afatmesme të shkollës lidhur me promovimin e shëndetit dhe mirëqenies së nxënësve
- ✚ Përfshirja e aktiviteteve në planet vjetore të shkollës lidhur me promovimin e shëndetit dhe mirëqenies së nxënësve
- ✚ Drejtoria e shkollës monitoron shërbimin psiko-social
- ✚ Drejtoria e shkollës monitoron shërbimin shëndetësor
- ✚ Drejtoria e shkollës monitoron shërbimin e pastrimit dhe higjienës
- ✚ Drejtoria e shkollës bashkëpunon me institucionet e edukimit, shëndetësisë, dhe qeverisjes lokale
- ✚ Veprimtarit e zhvilluara nga Komisioni i Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit
- ✚ Pjesëmarrja e Bordit të Shkollës, Këshillit të Prindërve, dhe Qeverisë së Nxënësve
- ✚ Komisioni i Etikës dhe Sjelljes, dhe Komisioni i Disiplinës punojnë aktivisht për të zgjidhur ankesat e nxënësve në lidhje me shëndetin, me mirëqenien dhe me veprimtaritë fizike

### 2.8.1 Qëllimi kryesor

**Qëllimi kryesor:** Monitorimi dhe dokumentimi/raportimi periodik i shërbimeve të promovimit të shëndetit në shkollë nga drejtori i institucionit arsimor tek ZVA.

### 2.8.2 Nën-Objektiva

- ✚ **Nën-Objektivi 1:** Hartimi i një dokumenti ku raportohet çdo veprimtari që zhvillon shërbimi psiko-social, shërbimi shëndetësor, shërbimi i pastrimit dhe higjienës, Komisioni i Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit, Bordi i Shkollës, Këshilli i Prindërve, Qeveria e Nxënësve dhe Komisioni i Etikës dhe Sjelljes, dhe Komisioni i Disiplinës.

### 2.8.3 Indikatorët e Performancës

Indikatorët e Performancës		
Matja e Indikatorëve të Performancës	Fakt 2022	Plan 2023
Përqindaja e shkollave që raportojnë periodikisht për shërbimet e promovimit të shëndetit në shkollë, tek ZVA.		
Përqindaja e shkollave që raportojnë periodikisht për shërbimin psiko-social në shkollë, tek ZVA.		
Përqindaja e shkollave që raportojnë periodikisht për shërbimin e pastrimit dhe higjienës në shkollë, tek ZVA.		

#### 2.8.4 Lista e veprimeve

Nr.	Nën-objektivi	Veprimi	Përgjegjës
1.	<p>Raportimi periodik i monitorimit të shërbimeve:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• psiko-social,</li> <li>• shëndetësor,</li> <li>• i pastrimit dhe higjenës,</li> <li>• Komisioni i Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit,</li> <li>• Bordi i Shkollës,</li> <li>• Këshillit të Prindërve,</li> <li>• Qeverisë së Nxënësve</li> <li>• Komisioni i Etikës dhe Sjelljes, dhe Komisioni i Disiplinës</li> </ul>	<p>- Të dokumentohet procesi i kontaktit të institucionit arsimor me OJF.</p> <p>- Të dokumentohet monitorimi i të gjitha shërbimeve të promovimit shëndetësor nga drejtori.</p> <p>- Të raportohet monitorimi i punës dhe i aktiviteteve që zhvillojnë bordi i shkollës dhe komisionet e ngritura.</p>	Drejtori i IA

#### 2.8.5 Lista e projekteve

<b>Nr. 1</b>	<b>Projekti:</b> Raportimi në mënyrë periodike i aktiviteteve të monitoruara nga drejtuesi i institucionit arsimor.
<b>a) Përshkrim i shkurtër i projektit:</b> Hartimi i një dokumenti të thjeshtë ku të raportohet periodikisht çdo shërbim.	
<p><b>i Situata</b> Bazuar në Urdhërin Nr.31, datë 28.01.2020 për “Miratimin e Rregullores për Funkcionimin e Institucioneve Arsimore Parauniversitare në Republikën e Shqipërisë” citohet sipas: <i>Neni 9- Veprimtaritë plotësuese</i> Veprimtaritë plotësuese, që zhvillohen në nivel institucioni arsimor, pasqyrohen në një dokument në të cilin tregohet synimi i veprimtarisë, pjesëmarrja dhe përshkruhet përmbledhtas ecuria e saj.</p> <p><i>Neni 66- Plani afatmesëm</i> Drejtori i shkollës i raporton një herë në vit bordit të shkollës për zbatimin e planit afatmesëm. Ndryshimet në planin afatmesëm miratohen nga bordi i shkollës.</p> <p><i>Neni 117- Siguria</i> 1. Drejtori harton raportin për çdo rast emergjence në institucion. 2. Drejtori i institucionit arsimor publik formulon periodikisht ose në kohë reale me sistem elektronik, për njësinë përkatëse të qeverisjes vendore, kërkesën e detajuar për mirëmbajtjen e institucionit, bazuar në pyetësonin e mirëmbajtjes.</p>	

Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për përmirësim	
Drejtori i shkollës e ka për detyrë të monitorojë dhe të raportoj në mënyrë periodike shërbimet në shkollë si dhe çdo aktivitet që kryhet në shkollë.	
ii Synimi i projektit Shkolla duke u bazuar në rregulloret e brendshme dhe në obligimet ligjore, duhet të raportoj në mënyrë periodike.	
iii Aktivitetet kryesore të projektit Raportimi në mënyrë periodike për çdo aktivitet nga drejtori tek ZVAP.	
<b>b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)</b> Rritja e kapaciteti raportues në nivel shkolle.	
Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda)  Drejtuesi i IA	Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj)